

REPubLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 897 Prot.

Gjirokastër, më: 23/07/2020.

V E N D I M
Nr. 14. Dt. 23. 07. 2020

Bazuar në nenin 6, pika 2, gërma d, si dhe nenit 10 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër", KIZ

V E N D O S I

1. Të miratojë dokumentacionin për akreditimin e vëzhguesve të cilët do të ndjekin procesin zgjedhor, si më poshtë:
 - a) Dokument identifikues (kartë identiteti/ pasaportë biometrike) një fotokopje e të cilit do të ruhet në KIZ;
 - b) Vërtetim nga Zyra e Personelit të Universitetit "Eqrem Çabej" për trupën akademike ose sekretaritë mësimore përkatëse për studentët, në të cilin të vërtetohet se është anëtar i trupës zgjedhore të universitetit;
 - c) Kërkesa e kandidatit për autoritet drejtues, në të cilin autorizohet personi përfaqësues;
 - d) Në rastin kur vëzhguesi vjen nga jashtë Univeritetit, ai duhet të paraqesë pranë KIZ autorizimin zyrtar të institucionit të interesuar.

2. Personat e akredituar në cilësinë e vëzhguesit kanë të drejtë që të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Ata janë të detyruar të zbatojnë rigorozisht të gjitha detyrimet që janë të parashikuara në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër" dhe vendimet e KIZ.

K R Y E T A R I

(Emër Mbiemër Firma)

Majlinda Probreh
Probreh

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Lomira Bobali

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Miljosh Luke

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Bleda Duka

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)
